

VENDIM
Nr. 579, datë 3.9.2014

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 99, DATË 18.2.2005, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KATALOGUT SHQIPTAR TË KLASIFIKIMIT TË
MBETJEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 68, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shtojcën I të Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve, miratuar me vendimin nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, në nënndarjen 16, klasifikimi 160103, “Gomat jashtë përdorimit”, të shtohen fjalët “... me përjashtim të granulatit të gomës, referuar Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, me kod nr. 4004 00 00 (mbeturina dhe kthime prej gome, pluhur prej gome dhe granulat e prodhimit prej tyre)”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama